



A.nr.349/2026

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi-Bajraktari, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.349/2026, të datës 25.03.2025 të parashtruar nga ankuesja N.L Z, nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.5, të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe në mbështetje me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 22.05.2026 mori këtë:

V E N D I M

Përfundon procedimi administrativ i iniciuar sipas ankesës A.nr.349/2026, të datës 25.03.2026, të parashtruar nga ankuesja N.L Z.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbimin civil, N.L Z (në tekstin e mëtejme referuar: ankuesja), përmes e-mailit të datës 25.03.2026, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër konkursit Nr. Reference: RN00019106 për pozitën Zyrtar i Zyrës Rajonale, të shpallur nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, ndërsa e njëjta më datë 18.05.2026, ka bërë tërheqjen e ankesës.

Kolegji i Këshillit, duke u bazuar në vlerësimin e provave të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, konstatoj se janë plotësuar kushtet ligjore për përfundimin e procedimit administrativ të iniciuar sipas ankesës së ankueses, **sepse:**

Kolegji i Këshillit pas pranimit të kërkesës së ankueses për tërheqje nga ankesa tw datws 18.05.2026 me numwr tw protokollit 2354, e duke u bazuar në nenin 103 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: “1. Një procedurë administrative e nisur sipas kërkesës, përfundon nëse pala që e ka bërë kërkesën e tërheq atë”, vendosi që të përfundoj procedurën administrative të iniciuar sipas ankesës me numër A.nr.349/2026, e datës 25.03.2026.

Theksuar si me sipër, e në mbështetje të nenit 18 paragrafit 1 nën paragrafit 1.5 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë Juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Administrative në Prishtinë- Departamenti për Konteste të Punës, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda:A.nr.349/2026, datë 20/05/2026

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit N.L Z;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.